

VENDIM
Nr. 735, datë 16.9.2020

PËR MIRATIMIN E LETËRMARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, DHE PROGRAMIT
PËR ZHVILLIM TË KOMBEVE TË BASHKUARA, PËR RIMBURSIMIN E TVSH-së
PËR 31 RESPIRATORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e letërmarrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara, për rimbursimin e TVSH-së për 31 respiratorë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

PROGRAMI PËR ZHVILLIM I KOMBEVE TË BASHKUARA

Tiranë, 13 korrik 2020

E nderuar Ministre Manastirliu

Lënda: Blerja e 31 ventilatorëve

Në kuadër të Lehtësimit të Angazhimit të PNUD-it “Reagimi ndaj COVID-19 në Shqipëri”, të cilën e kemi nënshkruar bashkërisht më 10 prill me ambasadorët e nderuar të Zvicrës dhe të Norvegjisë, kam kënaqësinë t’ju informoj se të gjithë ventilatorët tashmë kanë mbërritur në Shqipëri dhe u dorëzuan dhe u instaluan në spitalin “Nënë Tereza”.

Me kontributin nga qeveritë e Zvicrës, Norvegjisë, si dhe PNUD-it, kemi mbështetur Qeverinë e Shqipërisë në blerjen e 31 ventilatorëve si pajisje urgjente mjekësore në përgjigje ndaj COVID-19 dhe duke garantuar që sistemi shëndetësor shqiptar është pajisur më tej për luftimin e pandemisë.

Unë, gjithashtu, do të dëshiroja t’ju falënderoja për bashkëpunimin e vazhdueshëm të Ministrisë për të trajtuar çështjen e mbetur të TVSH-së dhe vlerësoj konfirmimin tuaj që ventilatorët do të mbeten në spitalin “Nënë Tereza” dhe që, sipas marrëveshjes së nënshkruar, mirëmbajtja e tyre do të sigurohet nga Ministria.

Më lejoni të ritheksoj falënderimet e mia për ju dhe qeveritë e Zvicrës dhe të Norvegjisë për bashkëpunimin dhe për mbështetjen e ofruar në Shqipëri në këtë krizë të paprecedentë, duke ofruar pajisje shëndetësore, e cila mund të shpëtojë jetë njerëzish.

Me respekt,
Limya Eltayeb
Përfaqësuese Rezidente

Nënshkrimi dhe vula

Shkëlqesia e saj znj. Ogerta Manastirliu
Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Republika e Shqipërisë

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD), rruga “Skënderbej”, Gurten Center, kati 2, Tiranë, Shqipëri.

Tel.: +355 4 2250205; 4 250224; e-mail: registry.al@undp.org; faqe interneti: www.undp.org.al

PROGRAMI PËR ZHVILLIM I KOMBEVE TË BASHKUARA

Tirana, 14 korrik 2020

E nderuar znj. Manastirliu

Lënda: Rimbursimi i TVSH-së për 31 ventilatorë

Në kuadër të Lehtësimit të Angazhimit të PNUD-it “Reagimi ndaj COVID-19 në Shqipëri”, të cilën e kemi nënshkruar bashkërisht më 10 prill me ambasadorët e nderuar të Zvicrës dhe të Norvegjisë, jam i kënaqur që Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara ishte i aftë të mbështeste me prokurimin dhe dhurimin e 31 ventilatorëve për Këshillin e Ministrave, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për të menaxhuar situatën e pandemisë të shkaktuar nga përhapja e shpejtë e infeksionit COVID-19. Kjo ishte e mundur për shkak të kontributeve nga Qeveria e Zvicrës dhe e Norvegjisë, si dhe Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD). Nëpërmjet këtij procesi, ne shpresojmë të kemi mbështetur Qeverinë e Shqipërisë në blerjen e ventilatorëve si pajisje urgjente mjekësore në përgjigje ndaj COVID-19 dhe duke garantuar që sistemi shëndetësor shqiptar të jetë i pajisur më tej për luftimin e pandemisë.

Siç është rënë dakord ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD-it), ne tashmë e kemi paguar shumën e TVSH-së lidhur me ventilatorët gjatë përfundimit të procedurave të zhdoganimit, me qëllim që të përshpejtojmë zhdoganimin dhe dorëzimin e këtyre ventilatorëve te përfituesi përfundimtar, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, brenda periudhës më të shkurtër të mundshme. Qeveria Shqiptare, nga ana tjetër, u zotua për të rimbursuar, brenda periudhës më të shkurtër të mundshme, shumën e TVSH-së tashmë të parapaguar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD). 31 ventilatorët, modeli VG70, i janë dhënë në dorëzim Spitalit Universitar “Nënë Tereza”, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur.

TVSH-ja totale e paguar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD) arrin në 13,663,270 lekë, sipas dokumenteve të zhdoganimit, bashkëlidhur si shtojca 1. Kjo shumë do të depozitohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Llogarinë Bankare shqiptare të PNUD-it në Bankën Intesa SanPaolo, pas nënshkrimit të kësaj letërmarrëveshjeje.

Emri i bankës:	Intesa Sanpaolo Bank
Emri i llogarisë:	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD)
Llogaria nr.:	1003730902
SWIFT:	USALALTR
IBAN nr.:	AL60208110080000001003730902
Monedha:	Lek

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD) në Shqipëri dhe unë e vlerësojmë realisht bashkëpunimin që kemi pasur dhe dëshirojmë t'i përcjellim ekipit tuaj dhe juve, sigurinë e konsideratës sonë më të lartë.

Me respekt,

Znj. Limya Eltayeb,
Përfaqësuese Rezidente
PNUD Shqipëri

Rënë dakord nga:

Znj. Ogerta Manastirliu,
Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale